A4 _ KUSHTET E VEÇANTA (ANEKSI I)

Këto kushte sqarojnë dhe plotësojnë, sipas nevojës, Kushtet e Përgjithshme që rregullojnë kontratën e furnizimit. Përveç rasteve kur Kushtet e Veçanta parashikojnë ndryshe, Kushtet e Përgjithshme mbeten të zbatueshme. Numërtimi i neneve të Kushteve të Veçanta nuk është i njëpasnjëshëm, por ndjek numërtimin e neneve të Kushteve të Përgjithshme. Në raste të jashtëzakonshme dhe me autorizimin e departamenteve përkatëse të Komisionit, mund të shtohen edhe klauzola të tjera për të mbuluar situata specifike.

Neni 2: Gjuha e kontratës

2.1 Gjuha e kontratës do të jetë anglisht ose shqip.

Neni 4: Komunikimet

4.1 Personat e kontaktit, adresat e palëve dhe të dhënat e tyre të kontaktit që do të përdoren nga Palët për komunikim janë siç përcaktohen në nenin 5 të Kontratës.

Neni 6: Nënkontraktimi

6.1 Nënkontraktimi nuk lejohet.

Neni 7: Sigurimi i dokumenteve

7.1. Autoriteti kontraktor nuk do t'i japë kontraktorit dokumente ose vizatime shtesë në kuadër të kësaj kontrate.

Neni 8: Ndihma lidhur me rregulloret vendore

8.1. Kontraktori duhet të njihet dhe të respektojë të gjitha ligjet, rregulloret dhe informacionet e zbatueshme mbi zakonet vendore, urdhrat ose aktet nënligjore të vendit ku do të dorëzohen furnizimet, të cilat mund të ndikojnë te kontraktori në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës. Autoriteti kontraktor nuk do të ofrojë asistencë për sigurimin e kopjeve ose dokumenteve të tilla.

Neni 10: Origjina

10.1 Të gjitha mallrat e blera mund të kenë origjinë nga çdo vend.

Neni 11: Garancia e ekzekutimit

11.1 Nuk kërkohet garanci e ekzekutimit.

Neni 12: Përgjegjësitë dhe sigurimi

12.2(b), paragrafi 2. Kontraktori do të marrë përsipër rreziqet dhe përgjegjësitë e nevojshme në përputhje me Incoterm-in[1] e zbatueshëm të përcaktuar në nenin 1 të Kontratës.

Neni 16: Rregullimet tatimore dhe doganore

16.1 Kushtet e dorëzimit (Incoterms 2020) do të jenë siç përcaktohen në nenin 1 të Kontratës, në vend të atyre të përmendura në Kushtet e Përgjithshme.

Neni 18: Urdhri i fillimit

18.1 Data në të cilën do të fillojë zbatimi i detyrave ("data e fillimit") do të jetë data e nënshkrimit të kontratës nga të dyja palët.

Neni 19: Periudha e zbatimit të detyrave

19.1 Periudha e zbatimit të detyrave do të jetë siç përcaktohet në nenin 1 të Kontratës.

Neni 25: Inspektimi dhe testimi

[1] Shih http://www.iccwbo.org/incoterms/

25.2 Mallrat e dorëzuara do të inspektohen dhe testohen në përputhje me nenin 25 të Kushteve të Përgjithshme në adresën e dorëzimit të përcaktuar në nenin 1 të Kontratës.

Neni 26: Parimet e përgjithshme për pagesat

26.1 Pagesat do të bëhen në monedhën e përcaktuar në nenin 3 të Kontratës. Nëse pagesat bëhen në monedhën vendase, kursi i këmbimit i zbatueshëm do të përcaktohet në përputhje me rregullat përkatëse të përcaktuara në marrëveshjen e financimit të programit/projektit përkatës.

26.5 Me përjashtim nga neni 26.5 i Kushteve të Përgjithshme, nuk kërkohet garanci për paradhënien.

Neni 29: Dorëzimi

29.3 Ambalazhimi do të bëhet pronë e përfituesit, duke iu nënshtruar konsideratave mjedisore.

29.5/6/7. Çdo dorëzim duhet të shoqërohet me një listë artikujsh drejtuar përfituesit.

Neni 31: Pranimi i përkohshëm

31.2. Me përjashtim nga paragrafi i dytë i nenit 31.2 të Kushteve të Përgjithshme, afati kohor i autoritetit kontraktor për lëshimin e certifikatës së pranimit të përkohshëm për kontraktorin nuk do të konsiderohet i përfshirë në afatin kohor për pagesat e përcaktuar në nenin 26.3.

Neni 32: Detyrimet e garancisë

32.6/7. Me përjashtim nga neni 32.7 i Kushteve të Përgjithshme, periudha e garancisë do të jetë periudha e përcaktuar në nenin 1 të Kontratës, e llogaritur nga data e pranimit të përkohshëm.

Neni 33: Shërbimi pas shitjes

33.1 Shërbimi pas shitjes do të ofrohet në përputhje me hollësitë e përcaktuara në specifikimet teknike.

Neni 40: Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

40.4 Çdo mosmarrëveshje që lind nga ose lidhet me këtë kontratë, e cila nuk mund të zgjidhet me mirëkuptim, do t'i referohet juridiksionit ekskluziv të gjykatave të Tiranës, Shqipëri.

Neni 44: Mbrojtja e të dhënave

44.1. Përpunimi i të dhënave personale që lidhen me zbatimin e kontratës do të kryhet në përputhje me Ligjin shqiptar Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", dhe me dispozitat e marrëveshjes përkatëse të financimit.

* * *